
D O K U M E N T E

EMINE ARIFI-BAKALLI

emine_bakalli@yahoo.com

POROSITË E MBRETIT ZOG DREJTUAR JUGOSLLAVISË APO PREMISAT BAZË PËR MARRËDHËNIE TË MIRA FQINJËSORE SHQIPTARO-JUGOSLLAVE

Fizionomia e dokumenteve në shqyrtim

Kësaj radhe po paraqesim dy dokumente të kohës, të cilat kanë të bëjnë me porositë e Mbretit Zog drejtuar Beogradit (prill 1932), si dhe një dokument tjetër përcjellës të tij. Fjala është për raportin e ministrit Fuqiptotë jugosllav në Shqipëri, J. Gjonoviq, lidhur me këto porosi, drejtuar ministrit të Punëve të Jashtme jugosllav të kohës, Marinkoviq, si dhe një analizë - raport i tij për politikën të cilën duhej të ndiqte Jugosllavia ndaj Shqipërisë. Këto dokumente i kam gjetur në fondin: Zbirka Vojislava Marinkovića - Maramboa, F-140, 40, Albania, Beograd 16 aprila 1932, në Arkivin Diplomantik jugosllav (Državni Arhiv Saveznog Sekretariata Inostranih Poslova - DASSIP), në Beograd. V. Jovanoviq-Marambo, ka qenë personalitet i dalluar në shumë rrafshë si dhe në atë diplomatik. Ky fond është produkt i angazhimit të tij, për grumbullimin dhe sistemimin e dokumenteve zyrtare shtetërore të zhvendosura gjatë Luftës së Dytë Botërore. Në përmbledhjen e tij gjenden edhe dokumente të tjera me vlerë që kanë të bëjnë me rrjedhat në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave, edhe pse në sasi modeste.

Dokumentet e sferës diplomatike me identitet të qartë institucional,¹ përkatësisht përmbajtja e tyre do të duhej të ishte e besueshme, gjë që nënkupton ndjeshmërinë e këtij rrafshi veprimtarie. E

¹ Ka raste të arkivimit të dokumenteve të servirura nga nëntoka për qëllime dhe efekte të caktuara. Identifikimi i autenticitetit të tyre mund të bëhet vetëm nga specialisti i kohës dhe i çështjes, i pajisur me njohje të duhur profesionale, sepse siç ka cekur Mustafa Kruja, "...edhe dokumentet janë si dëshmitarët: shumë herë dhe rrejñë" (Mustafa Kruja, *Antologji historike: shkrime e përkthime* (Elbasan: Sejko, 2001), 26).

megjithatë, ka mundësi që në to të hasen edhe nuanca egoje të shkruesve të tyre. Për shembull, në dokumentin e parë që kemi përpara, bie në sy një ndërhyrje ironike e Gjonoviqit lidhur me sentencën e mbretit shqiptar se “edhe këmishët do t’i shesim dhe borxhin do ta kthejmë [Italisë – E.A.B.],” por edhe cilësimi i Shqipërisë si “pion i Italisë”. Njohësi i rrethanave dhe sidomos i mënyrës së komunikimit të Mbretit Zog me të tjerët, vështirë se mund ta besojë këtë lloj ndërhyrjeje. Kjo, jo vetëm për faktin e pozitës së tij, por edhe për qëndrimin institucionalist dhe të matur në komunikim, pa marrë parasysh se kush ishte bashkëbiseduesi i tij. Mënyra e komunikimit të Mbretit Zog, i “çarmatoste” bashkëfolësit, përkundër predispozitave të tyre ndaj tij. Kjo vërehet në raportet e diplomatëve (jugosllavë e të tjerë), kujtimet si dhe shënimet e pjesës më të madhe të atyre që patën kontakt me Zogun. Por, në anën tjetër, duke njohur natyrën e vrazhdë të Gjonoviqit, mund të supozojmë që në bashkëbisedimin në fjalë, të ketë ndodhur ky reagim. Në fund të fundit, pak më vonë ai u qortua² nga Beogradi për mënyrën e komunikimit me autoritetet shqiptare dhe në vitin 1936, praktikisht përfundoi si një *non grata* për Shqipërinë.³

Konteksti politik i porosive nga Tirana

Që në fillim duhet të konstatojmë se audienca në fjalë, e cila pati për qëllim evidencimin e porosive të Mbretit Zog për qeverinë por edhe për mbretin jugosllav, dëshmon se tashmë të dyja palët ishin të interesuara që marrëdhëniet midis dy vendeve të kalonin në një rrafsh tjetër, më të shtendosur e më të avancuar. Pra, kjo audiencë nuk i ngjasonte një takimi rutinë e protokollar. Mund të thuhet se porositë e bëra me këtë rast, ishin një prelud i një kthese serioze në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave. Me fjalë të tjera, praktikisht, kemi të bëjmë me një riaktivizim të platformës së Kongresit të Lushnjës në orientimin e

² *Diplomatski Arhiv Saveznog Sekretariata Inostranih Poslova* (më tej: *DASSIP*), Londonsko Poslanstvo (LP), 1932, F-1, nr. 444, Beograd, 6 shtator 1932. Udhëzime për Gjonoviqin nga Kryeministri B. Jeftiq; “...ju lutem që t’i kushtoni kujdes të madh maturisë dhe të mos ndërmerrni asgjë pa marrëveshje dhe instruksione tona...” - porositet i përmenduri lidhur me reagimin e tij në kohën e zbulimit të Organizatës së Fshehtë antizogiste.

³ Për këtë shih tek Emine Arifi-Bakalli, *Drejti eliminimit të faktorit shqiptar në Ballkan - Qëndrimi i Jugosllavisë ndaj Shqipërisë dhe shqiptarëve 1935-1939*, Instituti i Historisë - Prishtinë (Prishtinë: 2023), 135.

jashtëm të Shqipërisë, e cila nënkuptonte edhe partnerë të caktuar strategjikë të jashtëm. Në këtë kontekst, sikurse edhe në kohën e Kongresit të Lushnjës, ky partner dilte të ishte Jugosllavia. Kjo kthesë, çoi në një afrim e bashkëpunim shqiptaro-jugosllav (1933-1934)⁴, që nuk kishte ndodhur asnjëherë më parë ndërmjet dy vendeve, pra, as në kohën kur edhe A. Zogu u kthye në krye të shtetit shqiptar përmes ndihmës infrastrukturore dhe politike të Beogradit (1924). Përcaktimi i Shqipërisë për këtë orientim të politikës së jashtme, kuptohet edhe nga përzgjedhja e diplomatit misionar të saj si ministër Fuqiplotë shqiptar në Beograd, Rauf Fico.⁵ Në fakt, porositë nga Tirana po bëheshin në periudhën kur Shqipëria po vazhdonte të ndërmernte hapa konkretë në relacion me Italinë, në mënyrë që marrëdhëniet me këtë shtet të sillleshin në suaza marrëdhëniesh normale ndërshtetërore. Masat emancipuese në raport me Italinë, u konsideruan të domosdoshme pasi Musolini tashmë po shfaqte synime dhe kërkesa të papranueshme për shtetin shqiptar.⁶

Në anën tjetër, interesimi i Jugosllavisë për marrëdhënie më të mira me Shqipërinë, po merrte prioritet si pasojë e qëndrimit të ngurtë dhe armiqësor italian në bisedimet e fshehta italo-jugosllave (1930-1932).⁷ Roma nuk tregoi asnjë predispozitë ndaj kërkesës së Beogradit që depërtimi i saj në Shqipëri të kufizohej vetëm në sferën ekonomike.⁸ Intenca e Beogradit që Roma të pajtohej me ekzistencën e shtetit jugosllav dhe Ballkani të pranohej si sferë e interesit të tij, dështoi. Përkundrazi, Benito Musolini tashmë po vepronte me vendosmëri drejt realizimit të synimeve imperialiste ndaj Ballkanit dhe po bënte plane për shkatërrimin e vetë shtetit jugosllav. Në këto rrethana, në Beograd nisi të predominonte ideja e përforcimit të marrëdhënieve me aleatët tradicionalë të tij (Francën), si dhe për forcimin e barrierave mbrojtëse (Antanta e Vogël) dhe formimin e tyre në nivel ballkanik (Pakti

⁴ Për këtë shih te Emine Arifi-Bakalli, *Marrëdhëniet ekonomike shqiptaro-jugosllave 1929-1939*, Instituti i Historisë-Prishtinë (Prishtinë: 1997).

⁵ Rauf Fico, si përfaqësues i përkohshëm kishte shërbyer edhe më herët në Beograd, ndërsa në fillim të prillit të vitit 1932 filloi punën si ministër Fuqiplotë atje, detyrë në të cilën qëndroi deri në fund të vitit 1936.

⁶ Shih tek Emine Arifi-Bakalli, *Përballje historiografike*, Instituti Albanologjik (Prishtinë: 2015), 77-97.

⁷ Bogdan Krizman, *Vanjska politika jugoslavenske drzave (1918-1941)* (Zagreb: Skolska Knjiga, 1975), 47.

⁸ Zvonimir Kulundžić, *Politika i korupcija u kraljevskoj Jugoslaviji* (Zagreb: NIP Stvarnost, 1968), 668.

Ballkanik).⁹ Në këtë kuadër, edhe Shqipëria rezultonte të ishte një element me peshë.

Duhet shtuar se përcaktimi i Tiranës dhe i Beogradit për afrim e bashkëpunim, nuk kishte të bënte vetëm me marrëdhëniet e tensionuara bilaterale të tyre me Romën, por edhe me rrjedhat e përgjithshme ndërkombëtare brenda viteve 1928-1932.¹⁰

Tri premisat bazë për afrim dhe marrëdhënie miqësore shqiptaro-jugosllave

Dokumentet në shqyrtim, pasqyrojnë më së miri karakterin e marrëdhënieve të Tiranës zyrtare dhe të vetë Mbretit Zog, me Beogradin. Pra, mbi cilat parime marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave mund të normalizoheshin, miqësoheshin dhe "madje dhe më shumë"^{*}, siç deklaroi mbreti shqiptar. Dihet se sot e kësaj dite, ndër interpretimet më kuturu të një pjese të historiografisë shqiptare dhe jo vetëm, ka të bëjë me karakterin e relacioneve të A. Zogut përkatësisht Mbretit Zog me Beogradin. Sipas këtij këndvështrimi, ky raport paraqitet si i afërt dhe klientelist. Madje, ka tendenca që në rreshta apo midis tyre, ky personalitet historik të vendoset në një rrafsh me Esad Pashë Toptanin ^{**}, një klientelist i besueshëm i Beogradit deri në vdekje. ^{***} Këta historianë dhe amatorë të shumtë në rrafshin historiografik, janë aq të mbërthyer nga deliri antizogist, sa i besojnë një "dokumenti" të lëshuar në qarkullim nga bota e nëndheshme në fund të vitit 1925, si një marrëveshje "Zogu-

⁹ Emine Arifi-Bakalli, *Çështje nga Historia Moderne dhe Bashkëkohore shqiptare*, Instituti Albanologjik-Prishtinë (Prishtinë: 2011). Vizitat e Mbretit Aleksandër në një varg shtetesh ballkanike, përjashto Shqipërinë, gjatë vitit 1933, ishin në funksion të këtij Pakti.

¹⁰ Arifi-Bakalli, *Çështje nga Historia Moderne*, 58-61.

* Kjo "më shumë" kishte të bënte me mundësinë e një marrëveshjeje të karakterit politik e për të cilën Jugosllavia mbeti e mbyllur deri në fund.

** Esad Pashë Toptani, pas fillimit të Luftës së Parë Botërore dhe largimit të V. Vidit nga Shqipëria, u kthye në Shqipëri përmes Nishit, ku qëndronte përkohësisht qeveria e N. Pashiqit. Ai shpalli një entitet politik, i cili shtrihej vetëm në Shqipërinë e Mesme. Flamuri i këtij entiteti ishte një sfond i kuq me një yll në cepin e tij. Ndërsa kërkesa e tij për Shqipërinë në kufijtë e vitit 1913, në kohën e Konferencës së Paqes në Paris, nuk ishte synim a vetëdije e tij politike, a nacionale, por thjesht akordim me qëndrimin dhe sugjerimin e Beogradit.

*** Edhe sot e kësaj dite, Esad Pashë Toptanin, qarqe politike e historiografike serbe e ngrenë në qiell dhe e konsiderojnë model të shqiptarit të mirë dhe të ndershëm.

Pashiq”.¹¹ Në këtë “dokument” evidencohet jo më pak se A. Zogu, kishte pranuar që Shqipëria të shndërrohej në një prefekturë të Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene. Në fakt, eksperti i formuar mbi bazën e hulumtimeve të ndërgjegjshme shkencore dhe pra, në rastin konkret, njohësi i burimeve arkivore jugosllave të kohës, shumë lehtë e përjashton mundësinë e çfarëdo marrëveshjeje me karakter të tillë. Kjo, edhe për faktin e thjeshtë sepse në komunikimin diplomatik shqiptaro-jugosllav (1925-1939), subjekti në fjalë mungon plotësisht. E nënkuptueshme që ky “subjekt” mungon edhe në këtë komunikim të hapur dhe kokë më kokë midis Mbretit Zog dhe ministrit energjik, Gjonoviq. Ky i fundit, i radhiti të gjitha momentet kyçe në raportet shqiptaro-serbe duke nisur me Luftën e Parë Ballkanike, përmendi përkrahjen që iu dha A. Zogut, bisedën e tij me Mbretin Aleksandër (1924), por nuk përmendi ekzistencën e ndonjë marrëveshjeje midis tij dhe Pashiqit, apo të ndonjë elementi a pike të cilat renditen në të ashtuquajturën “marrëveshje Zogu-Pashiq”.

Ndërsa, dokumenti i parë pasqyron karakterin e politikës shqiptare në relacion me Jugosllavinë, dokumenti i dytë ilustron politikën jugosllave në relacion me Shqipërinë në dy dimensionet e saj: atë publike që do të duhej të zbatohesh në kontekstin e dhënë shqiptar dhe ndërkombëtar, dhe, atë të fshehtë, që kishte të bënte me përgatitjen e terrenit brenda Shqipërisë, në mënyrë që në rrethana të tjera ndërkombëtare “çështja shqiptare” (albansko pitanje)^{*}, të zgjidhej në pajtim me synimet hegjemoniste serbe. Siç shihet nga dokumenti i dytë, një ndër komponentët e kësaj veprimtarie ishte edhe mundësia e rrëzimit përkatësisht eliminimit të Mbretit Zog, duke përgatitur alternativën e tij të lidhur me Beogradin.

Mbreti Zog edhe kësaj radhe, si dhe më vonë në komunikim me Beogradin, kërkoi përmbushjen e tri premisave bazë për fqinjësi të mirë shqiptaro-jugosllave:

1. *Jugosllavia duhej të hiqte dorë nga politika destabilizuese ndaj shtetit shqiptar;*
2. *Të akomodonte minoritetin shqiptar brenda saj;*
3. *Të reflektonte ndaj nevojave financiare dhe ekonomike të Shqipërisë.*

¹¹ Për këtë shih tek Arifi-Bakalli, *Përballje historiografike*, 125-163.

* Sintagma serbe “Albansko Pitanje”, ka të bëjë me shtetin shqiptar, me paqëndrueshmërinë e tij, me rishqyrtimin e tij.

I. Çështja e emigracionit politik shqiptar, apo kërkesa që të hiqej dorë nga destabilizimi i Shqipërisë

Shqipëria synonte stabilitet të brendshëm si premisë zhvillimi e përparimi, e jo vetëm ruajtjen e pavarësisë në suaza mbijetuese, siç pretendonte Beogradi.¹² Ky synim i shtetit shqiptar ishte vështirë i realizueshëm nën presionin e veprimtarisë aktive të emigracionit politik shqiptar, qoftë atij brenda Jugosllavisë apo dhe atij në Evropë e që subvencionohej nga Beogradi, siç ishte, bie fjala, organizata Bashkimi Kombëtar. Shërbimi informativ shqiptar ishte në dijeni të plotë të veprimeve të nëndheshme të shërbimeve jugosllave qoftë brenda Shqipërisë, qoftë jashtë saj.¹³ Pak pas kësaj audience, u burgosën dhe u dënuan pjesëtarë të Organizatës së Fshehtë antizogiste me qendër në Vlorë, të mbështetur nga Beogradi, për të cilën organizatë dhe individë të tjerë të lidhur me shërbimin jugosllav, bëhet fjalë në dokumentin e dytë që kemi përpara.

Në bashkëbisedim me Gjonoviçin, Mbreti shqiptar liston gjithë refuzimet e Beogradit për ndihmë, gjë që e detyroi në orientimin “adriatik” të Shqipërisë dhe spostimin e atij “ballkanik”, duke u ndalur në çështjen e emigracionit politik shqiptar në Jugosllavi. Pas atentatit kundër tij në Vjenë (1931), Mbreti Zog redaktorit të gazetës “Noje Fraje Presse”, ndër të tjera i deklaroi: “... Dua të theksoj se Historia ka dëshmuar që shqiptarët nuk mund të durojnë robërinë. Prandaj, kërkojmë nga fqinjët tanë që të respektojnë sovranitetin dhe integritetin e vendit tonë. Në kufirin tonë organizohen banda, të cilat shkaktojnë turbullira dhe dobësojnë fuqinë tonë ekonomike, pengohet konsolidimi i Shqipërisë dhe paqja në përgjithësi...”¹⁴

Në fakt, kërkesa e parë dhe e përhershme e mbretit shqiptar drejtuar Beogradit, kishte të bënte me veprimtarinë e këtij emigracioni. “Frenimi” i tij, siç kërkonte Tirana, nënkuptonte që Jugosllavia të hiqte dorë nga veprimtaria kundër stabilitetit politik të Shqipërisë, pajtimin e saj me

¹² Shih tek Arifi-Bakalli, *Drejt eliminimit*.

¹³ “Synimi afatshkurtër i Beogradit: një Shqipëri jo stabile, e varfër dhe e prapambetur nën tutelën e tij (një elaborat i proveniencës serbe për Shqipërinë 1929)”, në Arifi-Bakalli, *Përballje historiografike*, 227-253.

¹⁴ *Noje Fraje Presse*, 12.03.1931; *Shqipëria e Re*, 22.03.1931.

qëndrueshmërinë e shtetit shqiptar, si hap domethënës për marrëdhënie të mira fqinjësore. Por, kjo kërkesë binte ndesh me postulatin politik të N. Pashiqit, udhërrëfyes për politikën jugosllave. “Ne jemi për një Shqipëri të pavarur, por të dobët dhe të pa konsoliduar”,¹⁵ udhëzonte ai. Ky postulat u praktikua nga të gjithë ata që u morën me politikën dhe diplomacinë jugosllave. Ata, publikisht potenconin dhe deklaroheshin për komponentin e parë të këtij udhëzimi (pavarësia e Shqipërisë është interes jetik edhe për Jugosllavinë), ndërsa krahas kësaj, në fshehtësi punonin dhe angazhoheshin për komponentin e dytë, që ishte destabilizimi i saj dhe komprometimi në planin ndërkombëtar si shtet i dështuar.

Mesazhe të ngjashme nga Mbreti Zog drejtuar Beogradit, ishin bërë edhe një muaj pas shpalljes së Shqipërisë mbretëri dhe Zogut mbret të saj (1 tetor 1928).¹⁶ Këto porosi i drejtoheshin Mbretit Aleksandër përmes M. Jeliqit, i cili hiqej si mik i Mbretit Zog, që nga viti 1924.¹⁷ Në porositë e vitit 1928, Jugosllavia paralajmërohej se Shqipëria nuk do ta vazhdonte Paktin e Parë të Tiranës, pakt ky që u bë shkak për përkeqësimin e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave deri në ndërprerjen diplomatike të tyre (1927). “I thuaj Mbretit [Aleksandër – E.A.B.] që Pakti i Tiranës

¹⁵ *Arkivi i Jugosllavisë* (më tej: *AJ*), Fond: Milana Stojadinovića, F-37, Elaborat i Ivo Andriqit që mban datën 30 janar 1939; Por krahas kësaj, Pashiqi nuk ishte larg idesë së ndarjes së Shqipërisë me Italinë. Ai këtë propozim ia kishte bërë Karlo Sforcës, në një takim në Korfuz që në vitin 1917. (Karlo Sforca, *Neimari savremene Evrope* (Beograd: Kosmos, 1932), 155.)

¹⁶ *DASSIP*, Zbirka V. J.M., 1928, F. 21, “Albanija”. “Raport Kralju Jugoslavije o porukama albanskog Kralja Zogua I, od Milosava Jelića, 13.02.1919”.

¹⁷ M. Jeliq, gazetar, publicist, e me përvojë ushtarake, i cili në vitin 1924 bashkëpunoi ngushtë me Zogun edhe në përpilimin e planit të ndërhyrjes për rikthim në krye të Shqipërisë dhe më pas paraqitej si i afërt i tij. Në fillim të vitit 1924, ai vizitoi Shqipërinë dhe zhvilloi një varg intervistash me personalitete shqiptare të cilat më vonë i botoi në librin me titull: *Albanija, zapisi o ljudima i dogadjajima*, Izdavacka Knjizarnica, G. Kona, Beograd 1933, f. 42-45. M. Jeliq mbeti i magjepsur me A. Zogun. Ai këtë figurë historike shqiptare e përshkruan si: “I gjatë, trup të zhvilluar harmonik, sy të kaltër, flokë bojëkafë, mustaqe delikate, profil romak, qëndrim fisnik... Ajo çka mbetet gjatë në kujtesë është mënyra mbretërore e mbajtjes lart të kokës. Qëndrim koke që mban vetëm një princ. Sepse ky është pikërisht i tillë edhe nga ana familjare, edhe nga ana pronësore dhe nga edukata. Sidomos nga një prirje e lindur që njerëzit t’i binden dhe të realizojë atë që ai dëshiron. Deri kur do ta përcjell ky yll i shndritshëm fati, është çështje tjetër. Gjithsesi, ne largohemi me përshtypjen që pamë më të bukurën që Shqipëria ka në këtë çast”. Jeliqi, nuk lë pa përmendur edhe nënën e tij Sadije, si inteligjente.

skadon nga sot e një vit e gjysmë. Pas kësaj mbetet vetëm Pakti për aleancë [me Italinë – E.A.B.]”,¹⁸ deklaroi Mbreti Zog atëherë, gjë që edhe ndodhi. Mosvazhdimi* i këtij Pakti, si akt domethënës (1931), u pasua edhe me hapa të tjerë emancipues, të cilët mbreti shqiptar i përmend në këtë bisedë me Gjonoviqin. Këta hapa, sipas tij, do të vazhdonin deri në emancipimin e plotë ekonomik e politik të Shqipërisë në relacion me Italinë, dhe, kjo mund të arrihej me një përkrahje të gjithanshme e të sinqertë nga jashtë dhe konkretisht nga Jugosllavia, si më e interesuara që Italisë t’i mbyllej shtegu për depërtim në Ballkan.

II. Çështja e pozitës së shqiptarëve në Jugosllavi

Një tjetër çështje me peshë për cilësinë e marrëdhënieve me Jugosllavinë, ishte çështja e pozitës së shqiptarëve në këtë shtet. Mbreti shqiptar kërkonte, në fakt e luste Beogradin, që pozita e shqiptarëve të përmirësohej deri në atë shkallë, sa ata të mos detyroheshin të shpërnguleshin. A. Zogu, që nga fillimi kishte kërkuar dhe madje kushtëzuar marrëveshjen ekonomike me një marrëveshje konsullore (1926),¹⁹ e cila do t’i mundësonte Shqipërisë që të hapte konsullatat e saj në Jugosllavi. Në intervistën për shtypin jugosllav të bërë në fillim të vitit 1924, nga M. Jeliqi, Zogu përmendi nevojën imediate për marrëveshjen në fjalë.²⁰

Hapja e konsullatave shqiptare në viset e banuara me shqiptarë nënkuptonte monitorimin e drejtpërdrejtë të gjendjes së shqiptarëve në Kosovë dhe viset e tjera të banuara me ta.²¹ Në saje të kësaj marrëveshjeje, e cila nga Jugosllavia u ratifikua tre vjet pas nënshkrimit

¹⁸ DASSIP, Zbirka V. J.M., 1928, F. 21, “Albanija”. “Raport Kralju Jugoslavije o porukama albanskog Kralja Zogua, Beograd Izdavacka Knjizarnica G. Kona, 1933. I od Milosava Jelića, 13.02.1919”.

* Siç veprohej në këto raste, ishte paraparë edhe mundësia që Pakti të zgjatej edhe për pesë vjet të tjera.

¹⁹ *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, vëll. III, ASA, Instituti i Historisë (Tiranë: Botimet Albanologjike, 2022), 108.

²⁰ *Albanija, zapisi o ljudima i dogadjajima*, Izdavacka Knjizarnica, G. Kona (Beograd:1933), 42-45.

²¹ *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, vëll. III, 108.

të saj (1929)²², u arrit që të hapeshin dy konsullata shqiptare, njëra në Shkup dhe tjetra në Manastir. Kërkesa e palës shqiptare që njëra ndër to të hapej diku në brendësi të Kosovës, u refuzua nga pala jugosllave. Ministri Fuqiplotë shqiptar në Jugosllavi, R. Fico, që nga prilli i vitit 1932 e deri në vitin 1936, çështjen e përmirësimit të pozitës së shqiptarëve në Jugosllavi e shtroi me insistim, si në takimet zyrtare, ato jozyrtare, madje edhe në pritje rasti. Në periudhën e afrimit ndërshtetëror, Fico mori përgjigje premtuese për hapjen e shkollave bazike minoritare për shqiptarët nga vetë ministrat e Punëve të Jashtme jugosllavë, Marinković e Jevtiq.²³ Edhe kjo e dhënë, lidhur me premtimin e Beogradit për mundësinë e hapjes së shkollave bazike për shqiptarët, pasqyron predispozitën e tij për afrim me Shqipërinë. Sikurse edhe predispozita, apo më mirë nevoja për afrim me Beogradin, bëri që Tirana të heqë dorë nga adresimi i çështjes së pozitës së shqiptarëve në Lidhjen e Kombeve. Në fakt, kjo çështje mbeti në suaza të “premtimeve” shumë kursyera dhe boshe nga ana e Jugosllavisë dhe e shpresave të kota nga ana e Shqipërisë.

Siç shihet nga dokumenti i parë, edhe në mënyrën e shtruarjes së çështjes të pozitës së shqiptarëve në Jugosllavi nga ana e mbretit shqiptar, ka shumë delikatesë pragmatiste, gjë që është një tipar i nënkuptueshëm dhe i qëndrueshëm gjatë gjithë veprimtarisë aktive politike të këtij personaliteti politik-historik shqiptar. Sipas Mbretit Zog, shqiptarëve në Jugosllavi u duhej lehtësuar jeta deri në masën që të mos shpërnguleshin; ata mund të ishin të vlefshëm për Beogradin; të ikurit nga andej ishin barrë e madhe financiare për shtetin shqiptar; Beogradi nuk kishte përse të druhej nga mundësia e ndonjë synimi irredentist, sepse Tirana “nuk kishte asnjë qëllim ndaj tyre dhe territoreve që ata banojnë”.

Mendoj se edhe në këtë kuadër të kësaj analize, ka nevojë të evidencohet një anomali në historiografinë shqiptare, siç është, bie fjala, sintagma e hasur në shumë tituj e përmbajtje, e që është “çështja e Kosovës” në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave.²⁴ Kjo, për arsyen e

²² Emine Arifi-Bakalli, “Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1925-1939”, në *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, vëll. III, ASA, Instituti i Historisë (Tiranë: Botimet Albanologjike, 2022), 108.

²³ *AMPJ*, V. 1932, D. 118, fl. 24. Shkresë e ministrit Fuqiplotë shqiptar në Beograd, R. Fico drejtuar MPJSH-së, Beograd, 23 nëntor 1932.

²⁴ Për këtë shih tek E. Arifi-Bakalli, “Çështja e Kosovës” apo çështje lidhur me shqiptarët e Kosovës në Parlamentin shqiptar në vitet 1925-1939”, në *100 vjet*

thjeshtë sepse një çështje e tillë që nënkupton kontekst territorial-etnik shqiptaro-jugosllav, nuk është shtruar asnjëherë, pra është inekzistente.* Nëse ky formulim evidencohet me ngulm, me kohë shndërrohet në një keqinformim funksionues, të cilin do ta evidencojë - përvetësojë edhe inteligjenca artificiale.²⁵ Në këtë mënyrë, keqinformimi në fjalë infekton të njëjtën, dhe përhapet në plan të gjerë.

III. Bashkëpunimi ekonomik

Porosia e tretë e mbretit shqiptar për Beogradin, kishte të bënte me bashkëpunimin në planin ekonomik, i cili duhej të bazohej në një marrëveshje ekonomike preferenciale dhe me aktivizimin e një çështjeje shumë të vjetër, siç ishte çështja e rregullimit të ujërave të Drinit, përkatësisht tharjen e Liqenit të Shkodrës.²⁶ Por, ajo që ishte me rëndësi, angazhimi i të dyja palëve në këtë plan, nënkuptonte edhe angazhimin e kapitalit frëng, i cili kishte shfaqur interesim për këtë projekt që nga koha e Perandorisë Osmane. “Ju lutem mos lejoni që vetëm italianët të zhvillojnë aktivitet në Shqipëri. Angazhohuni edhe ju me miqtë tuaj”, deklaroi Mbreti Zog. Por jo. Ky projekt mbeti në suaza të një dëshire të mirë, edhe pse ideja për të nuk reshti asnjëherë.

Siç shihet nga dokumenti i dytë, Gjonoviçi, ishte i mendimit që të zbatoheshin një pjesë e mirë e formave të bashkëpunimit të propozuara nga mbreti shqiptar. Por, dihet se marrëveshjet e karakterit ekonomik të arritura gjatë viteve 1933-1934, mbetën në letër dhe kryesisht dështuan.²⁷ Ky dështim kishte të bënte edhe me rrjedhat në planin ndërkombëtar. Pas instalimit të nazizmit në krye të Gjermanisë dhe mundësisë që Italia të afrohej me të, Franca së bashku me Britaninë e Madhe, bënë çmos që kjo mundësi të eliminohej, ose së paku të shtyhej sa më shumë. E kjo mund

parlamentarizëm shqiptar, Konferencë Shkencore Ndërkombëtare, përgatitur nga Shërbimi i Botimeve Parlamentare (Tiranë: 2020).

* Bëhet fjalë për vitet 1925-1939.

²⁵ Një “komunikim” me këtë inteligjencë dhe mënyra se si m’u përgjigj në pyetjen e shtruar lidhur me një çështje nga e kaluara, më ballafaqoi me këtë çështje. Inteligjenca artificiale gabonte, por jo për fajin e saj po për fajin e historianëve shqiptarë.

²⁶ Shih tek Emine Arifi-Bakalli, *Marrëdhëniet ekonomike shqiptaro-jugosllave (1929-1939)*, Instituti i Historisë-Prishtinë (Prishtinë: 1997), 173.

²⁷ *Po aty*.

të arrihej me joshjen e Musolinit me shumëçka, e sidomos me Shqipërinë.

Raport i ministrit Fuqiptotë jugosllav J. Gjonoviq, lidhur me porositë e Mbretit Zog drejtuar ministrit të Punëve të Jashtme jugosllav, Marinkoviq

“Zoti ministër,

Beograd, 16 prill 1932

Më 5 prill, u pranova në audiencë nga Mbreti Zog. Me rastin e kësaj audience, biseda midis nesh u zhvillua si vijon:

Mbretit i deklarova se po nisesha për në Beograd dhe që dëshiroja të shihja dhe të dëgjoja çfarë porosish kishte ai për Beogradin.

Mbreti m'u përgjigj:

“Unë mendoj se marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë duhet të jenë miqësore. Madje, edhe më shumë. Së pari, unë dua t'ju flas për tri çështje për të cilat me kërkesën time, ju ka folur z. Konica.* Do të flas haptazi. Dua që haptazi dhe sinqerisht t'ju bëj me dije, për mendimin tim, për të gjitha çështjet të cilat u interesojnë vendeve tona. Fillimisht, për çështjen e emigracionit tonë. Unë nuk kam asgjë kundër që ju ta ndihmoni dhe mbani emigracionin tonë. Vetëm se, do t'ju lutesha që pasi veç e mbani, ta largoni nga kufiri, sepse përderisa ata do të qëndrojnë pranë kufirit, janë të mundshme incidentet dhe shqetësimet. Përveç kësaj, duke dashur që të mos e interpretoni si ndërhyrje në punët tuaja [të brendshme – E.A.B.], do t'ju lutesha që lidhur me mënyrën e trajtimit të shqiptarëve nga shtetasit tuaj, të mos bëheni shkas që ata të shpërngulen. Për mua, ata paraqesin një barrë. Më shkaktojnë vështirësi. Këtë vit kam qenë i detyruar që për ushqimin e tyre të ndaj të ardhura të mëdha. Pjesën më të madhe për shkak të emigracionit të ardhur nga vendi juaj. Unë mendoj që ata për ju mund të jenë të dobishëm dhe që ju duhet t'i ndalni që të mos shpërngulen. Të jeni të sigurt se ne nuk kemi kurrfarë qëllimesh ndaj tyre apo ndaj territoreve të cilat ata i banojnë. Së fundi, ju lutem, që së bashku të angazhohemi që të zgjidhet çështja e rregullimit të Drinit. Ky do të ishte angazhimi i parë i madh i përbashkët, i cili nuk do

* Fjala është për Mehmet Konicën, i cili kishte reputacionin e një ballkanofili dhe deri vonë gëzoi besimin e plotë të Beogradit.

të ndikonte vetëm në planin ekonomik, por edhe atë politik. Me një fjalë, do të na afronte”.

Mbretit i deklarova se më vinte mirë që ai dëshironte të fliste haptazi, dhe se, edhe unë do të shfaqja mendimin tim haptazi dhe qartë, për të gjitha çështjet. Lidhur me emigracionin, i deklarova se nuk kishte përse të frikësohet nga ky [emigracioni-E.A.B.]. Ne nuk do të lejojmë që ai të veprojë në mënyrë të papërgjegjshme dhe që të shkaktojë incidente. Se nuk mund ta largojmë nga kufiri pasi ata në të shumtën janë pranë kufirit* dhe, si të tillë, banojnë tek të njohurit dhe miqtë e tyre në territorin tonë. Nëse do t’i largonim në brendësi, do të na shkaktoheshin goxha shpenzime, të cilat ne nuk duam t’i bëjmë. Lidhur me çështjen e emigrimit nga Kosova, i thashë se ne nuk e sforcojmë këtë. Te ne ligjet janë për të gjithë njësoj dhe zbatohen për të gjithë në të njëjtën mënyrë. Nëse qytetarët i respektojnë ligjet, nuk kanë përse të frikësohen dhe as arsye për të ikur. Ata nuk duhet të çojnë kokë ose të futen në kolizion me ligjet e vendit, dhe në këtë rast do të jenë të qetë. Por, ata që shkelin ligjet nuk mund të trajtohen ndryshe, përveçse siç e parasheh ligji. Në fund, i thashë se, te ne ekziston vullnet i mirë për çështjen e rregullimit të Drinit. Madhëria e Tij Mbreti Aleksandër dhe qeveria mbretërore, kanë dëshirë që çështja të zgjidhet dhe më kanë autorizuar që të angazhohem në këtë plan. Mbreti më deklaroi se gëzohet që Lartmadhëria Mbreti dhe qeveria, mendojnë sikurse edhe ai më informoi, se e ka autorizuar z. Mehmet Konica që ta studiojë këtë çështje dhe të drejtojë bashkëbisedimet me ne. I premtova se, kur të kthehem nga Beogradi, do të fillojmë bisedimet dhe do të përkujdesemi që të gjejmë mënyrën që kjo çështje të zgjidhet për së mbari. Mbretit Zog i thashë që, në fund të fundit, kjo çështje si çdo çështje tjetër, varet nga ajo më kryesorja siç është besimi midis nesh. Nëse marrëdhëniet politike midis nesh do të jenë të mira dhe korrekte, atëherë çdo çështje zgjidhet lehtë. Me këtë rast, i thashë se do të jem i drejtpërdrejtë dhe i hapur, dhe t’i them se te ne nuk ka shumë besim në politikën e Shqipërisë dhe se po krijohet përshtypja që Shqipëria është shndërruar, nëse jo në një koloni, në një pion të politikës italiane kundër nesh. Më pyeti për arsyet e kësaj bindjeje. Unë iu përgjigja:

a) Së pari, sepse nga italianët po merrni shuma të mëdha mjetesh dhe po obligoheni me borxhe jashtë mundësive për t’i kthyer. Sikur këto mjete t’i merrnit nga ndonjë vend i largët, mund të ndodhte që të

* Persona matanë kufirit, pranë atij me Jugosllavinë.

deklaroni se nuk mund t'i ktheni, siç kanë bërë edhe të tjerët. Por, ndryshe ndodh kur mjetet [financiare – E.A.B.] i merrni nga një vend, i cili botërisht ka deklaruar që ka interesa specialë te ju dhe që ka synime konkrete imperialiste dhe pikërisht në këtë pjesë të Evropës. Kjo situatë është e rrezikshme. Ju po bini dhe jeni të detyruar që të bini nën ndikimin gjithnjë e më të madh të saj [Italisë – E.A.B.]. Unë nuk shoh ndonjë mënyrë si mund të liroheni, sidomos nëse vazhdoni të ndiqni këtë kurs. Ne nuk mund t'ju financojmë që të nxirreni [nga kjo situatë – E.A.B.]; në Evropë aktualisht është e pamundshme që të sigurohen hua të jashtme, dhe, si do të liroheni nga presioni i kapitalit, të cilin po e merrni gjithnjë e më tepër?

- Do t'i shesim edhe këmishët dhe borxhin do ta kthejmë, - më deklaroi Zogu.
- Më fal, por më duket se këmishët tuaja nuk mund t'ju ofrojnë aq shuma të mëdha, - shtova.

b) Që Shqipëria po shndërrohet në një pion të politikës italiane kundër nesh, te ne mendohet edhe ngaqë e gjithë administrata juaj është e predispozuar armiqësisht ndaj nesh. Kjo frymë e administratës shqiptare nuk i shërben Shqipërisë, por u duhet miqve tuaj [italianëve – E.A.B.]. Unë kam përshtypjen se në administratën tuaj po thellohet ndjenja armiqësore ndaj nesh, kryesisht duke u nisur nga ngarkesa të ndryshme, sipas të cilave ne jemi armiq të tuaj. Por, kjo nuk qëndron. Supozimi në themel nuk qëndron. Ne nuk jemi armiq të tuaj, përkundrazi, ne jemi garantuesit e pavarësisë suaj.

c) Arsyeja e tretë në të cilën bazohet bindja jonë që ju jeni pion i politikës italiane, është fakti që italianët mbajnë në duar forcën tuaj të armatosur, në mënyrë që t'ju armatosin përtej nevojave tuaja reale dhe të ngrenë fortifikime drejtuar kundër nesh me paragjykimin që ne jemi armiq të tuaj.

Lidhur me këtë ekspozë timen, mbreti u përgjigj në këtë mënyrë:

“Unë jam patriot dhe prandaj nuk do ta shes vendin tim. Të jeni të sigurt që Shqipëria nuk do të shndërrohet në një koloni italiane dhe as vegël kundër jush. Unë ju kam thënë që ne do t'i paguajmë borxhet tona, me çdo kusht. Ju e dini se për sa i përket ushtrisë, oficerët italianë kanë komanduar batalione, regjimente dhe divizione. Unë i kam zëvendësuar me oficerët tanë, sapo ato janë formuar. Aktualisht, prezenca e italianëve evidencohet vetëm në artileri dhe në shtabe. Sapo të më përgatiten artiljerët e mi, do t'i largoj italianët. Unë tashmë i kam larguar dhe

zëvendësuar 20 oficerë italianë, edhe për arsye se nuk mund t'i paguaj. Vitin vijues do t'i largoj nga pozitat komanduese të gjithë. Ata do të mbesin vetëm në shtabe dhe në shkollat ushtarake. Por edhe në këtë sferë gradualisht do t'i eliminoj. Për këtë më duhet kohë. Më lejoni t'ju them se për marrëdhëniet e mia me italianët fajtor jeni ju. Unë nga ju kam kërkuar ndihmë financiare, jo si dhuratë, por si hua. Nuk ma dhatë. Kam kërkuar oficerë si instruktorë. Nuk m'i dhatë. Ju kam lutur që të më pranoni në Antantën e Vogël. Nuk deshët. Ju kam kërkuar që të më ndihmoni që të siguroj ndihmë nga Lidhja e Kombeve. Nuk sigurova dot. Kam kërkuar [ndihmë - hua financiare – E.A.B.] nga frëngët, anglezët deri dhe nga gjermanët. Nuk mora dot. Kam qenë i detyruar që të organizoj shtetin dhe për këtë qëllim kam pranuar ndihmë nga ana e vetme e mundshme. Por, përkundër kësaj, ju lutem e informoni Beogradin që ne nuk do ta komprometojmë pavarësinë tonë.”

Pas kësaj deklarate të mbretit, konsiderova që e kisha për detyrë t'ia thosha këtë:

Lartmadhëri, sinqeriteti dhe qëndrimi juaj i hapur më detyron që t'ju them se, megjithatë unë kam frikë për pavarësinë tuaj. Ne e dimë nga përvoja, shumë e hidhur, që Fuqitë e Mëdha nuk vijnë në Ballkan të shtyrë nga qëllime altruiste dhe se të njëjtat si rregull shndërrohen në rrezik për lirinë e Ballkanit. E sheh, që ne nuk kërkojmë asgjë më shumë veçse ta ruani pavarësinë tuaj, jo vetëm për ju, por edhe për ne. Për fat apo fatkeqësisht, ne jemi të parapërcaktuar që të përkujdesemi për lirinë e Ballkanit. Ballkani ka qenë i lirë me lirinë tonë dhe e ka humbur lirinë kur ne e humbim. Kështu ka qenë në të kaluarën dhe kështu do të jetë edhe në të ardhmen. Në këtë mënyrë, nga imponimi i rrethanave dhe për domosdoshmërinë e rendit në Ballkan, ne jemi garancia e lirisë suaj. Prandaj ne frikësohemi që në relacion me italianët keni shkuar tepër larg dhe, në këtë mënyrë, keni krijuar situatën nga e cila mund të lindin konflikte në Ballkan. Dhe, pasi ju konstatuat se ne jemi përgjegjës për orientimin tuaj politik, më lejoni që të konstatojmë disa fakte të qëndrueshme historike: së pari, ne kemi qenë në konflikt me ju përderisa keni zhvilluar politikë të huaj, dhe, së dyti, gjithmonë ju kemi ndihmuar kur keni zhvilluar politikën tuaj të pavarur shqiptare. Bie fjala, shqiptarët kanë luajtur në kartën turke dhe duke luftuar së bashku me turqit kemi luftuar me ta. Më tej, keni luajtur në kartën austriake dhe duke luftuar me Austrinë, kemi luftuar me ju. Aktualisht po luani me kartën italiane dhe duke gjetur mbrojtje nga kjo anë, ne nuk mund të jemi miq, përkundrazi

jemi të detyruar të luftojmë me ju. E çka ju duhet kjo? Përse gjithmonë të bëhen gabime historike? Kjo sigurisht nuk ju duhet. Kurse, shihni, kur keni zhvilluar politikën tuaj, gjithmonë ju kemi ndihmuar. Që të mos shkojmë shumë larg dhe të nisemi nga kohët e reja. Në Konferencën e Paqes, përfaqësuesi i Serbisë ka qenë shtetari i parë i Evropës, i cili, në emër të një vendi, shqiptarëve ua ka pranuar të drejtën në organizimin e shtetit të pavarur. Kjo është e vërteta historike. Pas kësaj kemi dashur që t'ju inkurajojmë në mënyrë që t'i tregoni botës se jeni të aftë që të realizoni shtetin, dhe jo ta fitoni atë si produkt të kombinimeve. Kjo është etapa e dytë në krijimin e shtetit tuaj. Prandaj ju kemi ndihmuar që italianët t'i hidhni në det. Mandej kemi bërë hapin e tretë, duke ju ndihmuar që të organizoni shtetin e krijuar. Pasi kemi analizuar se cilin shqiptar do të ndihmojmë që të organizojë shtetin, përzgjedhja jonë ka rënë në organizatorin më të mirë dhe njeriun me vlera të mëdha, dhe e kemi sjellë në Shqipëri. Ky keni qenë ju. Siç po e shihni, sa herë që shqiptarët kanë zhvilluar politikë të pavarur, ne i kemi ndihmuar. Jemi të gatshëm që t'i ndihmojmë edhe në të ardhmen. Mirëpo gabimi ynë dhe përgjegjësia jonë nuk mund të përsëriten nëse ju nuk zhvilloni politikë të pavarur, por do t'iu nënshtroheni politikave të huaja dhe interesave të të tjerëve. Lartmadhëri, desha t'ju pyes se a jeni të sigurt që ata [italianët – E.A.B.] nuk kanë tentuar që të bisedojnë për vendin tuaj? Por, ju mund të jeni të qetë nga ana jonë. Por, ju mund të jeni të qetë nga ana jonë. Sa ju përket juve, ne qëndrojmë mbi bazën e politikës të cilën N. M. e Tij, Mbreti Aleksandër, ju ka bërë të ditur në kohën kur keni qëndruar në Beograd.* Ne dëshirojmë që ju të zbatoni një politikë shqiptare dhe ballkanike, të jeni të pavarur e të ruani lirinë tuaj. Kjo është ajo që ne gjithnjë dhe kudo e theksojmë, dhe kjo është ajo që bën që ne të mos pranojmë kurrfarë bisedimesh lidhur me ju, e të cilat nuk do ta përforconin këtë lloj politike. Prandaj, qëndrimi i Jugosllavisë ndaj vendit tuaj varet nga ju, e jo nga ne. Politika jonë ndaj jush është e pastër dhe e qartë: të jeni të lirë dhe të pavarur. Në këtë rrugë gjithherë do ta kini përkrahjen tonë.

Mbreti më falënderoi për transparencën dhe pranoi që është e saktë e gjithë ajo që thashë, dhe shtoi:

* Fjala është për ndonjë takim në kohën kur A. Zogu ishte strehuar në Beograd në vitin 1924.

Ju lutem që L.M. së Tij Mbretit Aleksandër dhe qeverisë mbretërore t'ju bëni me dije se ne do të ruajmë pavarësinë tonë, dhe se politika jonë nuk do të bëhet shkak për shpërthimin e asnjë lloj konflikti në Ballkan. Ne do të pakësojmë shpenzimet tona, në mënyrë që ta zvogëlojmë nevojën për ndihmë të jashtme dhe do të bëjmë gjithçka nga ana jonë që midis nesh të krijohen marrëdhënie miqësore, madje edhe më shumë. Lidhur me informatën tuaj për lëvizjet e komitëve dhe të kaçakëve, unë kam urdhëruar në mënyrë të prerë, që asnjë veprim nuk do të ndërmerret nga territori ynë. Për t'ju bindur se po flas të vërtetën, ju lutem që, posa të informoheni se po përgatiten veprime të tilla të papërgjegjshme, apo që kriminelët po e kalojnë kufirin, më informoni dhe menjëherë do të varen. Është e mundshme që kufirin ta kalojnë hajdutë, por unë të tillët i var sa herë që t'i zë. Aksione të organizuara, të ndihmuara nga autoritetet shqiptare absolutisht nuk mund dhe nuk guxon të ketë. Nuk i lejoj Komitetit maqedonas dhe askujt tjetër, që nga vendi ynë të zhvillojë aktivitete kundër sigurisë publike te ju. Sa i përket kësaj të jeni të sigurt. Për marrëdhënie korrekte dhe miqësore midis nesh, unë ju lus që së bashku të angazhohemi që çështjen e pronarëve përtej kufirit, ta zgjidhim në mënyrën më të drejtë, po ashtu edhe çështjen e ekstradimit të kriminelëve dhe të zhvillojmë marrëdhëniet tona ekonomike. Në këtë plan do të mund të arrinim një marrëveshje ekonomike preferenciale. Unë tashmë e kam caktuar z. Konica që të studiojë çështjen e rregullimit të Drinit. Këtë çështje duhet ta sfancojmë. Në përgjithësi, të gjitha çështjet ekonomike të shtyhen përpara dhe unë nga ana ime do të angazhohem që të gjejnë një zgjidhje të favorshme. Ju lutem, mos lejoni që vetëm italianët të zhvillojnë aktivitet në Shqipëri. Angazhohuni edhe ju me miqtë tuaj.

I thashë se jam duke studiuar mundësitë e zgjerimit të lidhjeve ekonomike dhe me t'u kthyer nga Beogradi do të parashtoj çka mendojmë dhe çka mund të bëjmë.

Mbreti në fund më deklaroi, që në përgjithësi “për të gjitha çështjet të cilat nëpunësit tuaj nuk mund t'i zgjidhin me qeverinë time, më lajmëroni dhe do të urdhëroj që të gjitha të gjejnë zgjidhje”.

Më pyeti a do të takohem me L.M. e Tij, Mbretin. Iu përgjigja se besoj se po. Më luti që të transmetoj:

“Përsëndete N. M. e Tij Mbretin Aleksandër, dhe i thoni që unë i kam parasysh sugjerimet e tij. Që po zhvilloj dhe do të zhvilloj atë politikë dhe se nuk do të komprometoj lirinë dhe pavarësinë e vendit tim”.

Zoti ministër, duke ju informuar lidhur me këtë intervistë, mendoj se do të duhet që të gjejmë zgjidhje për çështjet e shtruara. Unë, në referatin drejtuar juve, e kam shfaqur mendimin tim lidhur me këto dhe çështje të tjera, që kanë të bëjnë me politikën tonë në Shqipëri.

Ju lutem, pranoni...”.

Referat i J. Gjonoviqit lidhur me politikën jugosllave ndaj Shqipërisë, për ministrin e Punëve të Jashtme dr. Vojislav Marinkoviq

“Zoti ministër,

Në raportin tim nr. 515, kam cekur se jam i bindur që Mbreti Zog dhe regjimi i tij, nuk kanë mundësi, madje edhe sikur të donin, t’i ikin ndikimit italian. Arsyet janë këto:

a) Kanë iniciuar [shqiptarët – E.A.B.] ndërtime përtej mundësive reale ekonomike të vendit. Pranojnë ndihmë financiare nga një fuqi e madhe, e cila i konsideron bazë për penetrim në Ballkan.

b) Organizojnë dhe mbajnë ushtri më të madhe, sesa iu duhet. Për të dhe për xhandarmërinë shpenzojnë gati gjysmën e buxhetit. Për mirëmbajtjen e tyre marrin hua pa kamatë prej 10 milionë fr. ari. Zvogëlimi i shpenzimeve nënkupton reduktimin e ushtrisë. Nga ky hap hezitojnë ngase frikësohen, sepse, sipas mentalitetit të tyre, të gjithë ata që do të mbeteshin pa rrogë dhe pa benefite do të shndërroheshin në revolucionarë. Tatimet nuk mund t’i ngrenë. Në fund të fundit me këtë ngritje, nuk do të përfitonin asgjë. Prandaj janë të destinuar për ndihmën italiane, si të vetmin burim financiar.

c) Ata kanë marrëveshje për aleancë për 20 vjet [me Italinë – E.A.B.]. Kjo i obligon që të mos lidhin marrëveshje me shtetet e tjera, pa miratimin e Italisë.

Si rrjedhojë, me një politikë të kalkuluar keq, kanë arritur në një pozitë nga e cila është shumë vështirë dhe gati e pamundshme që të shkëputen nga ndikimi italian, përveçse nëse dikush tjetër i merr si barrë mbi vete. Prandaj, përderisa Zogu është mbret i Shqipërisë, më së shumti që mund të presim janë marrëdhëniet korrekte fqinjësore me të, dhe shkallë-shkallë të realizojmë penetrimin ekonomik në këtë vend. Kjo

mund të arrihet si vijon: Duke evituar incidentet në kufi; zbatimin e konventës për ekstradimin e kriminelëve; me ndërmarrje të përbashkët në rregullimin e Drinit; një zgjidhje më të mirë të çështjeve që kanë të bëjnë me pronarët përtej kufirit; me intensifikimin e shkëmbimit midis nesh; dhe, së fundi, me zgjidhjen e çështjes së kishës.

1. Duke evituar incidentet [në kufi – E.A.B.], do të arrihej qetësimi i shpirtrave dhe agjitacioni se mbretit dhe regjimit i kanoset rreziku nga ana e jonë, do të tregohej i pasaktë. Një aksion intensiv* nga ana jonë, ata do t'i lidhte edhe më tepër me Italinë.

2. Duke i dorëzuar kriminelët ordererë do të ndikohej në uljen e kriminalitetit edhe te ne, edhe tek ata. Krahas kësaj, do të shprehej vullneti i mirë për bashkëpunim në planin e evitimit të kriminalitetit. Gjatë procesit të dorëzimit të kriminelëve, do të duhej të përkuqdesemi që të dorëzohen edhe kriminelët e kombësisë së tyre, e sidomos plaçkitësit. Më së miri është zgjidhja konkrete lidhur me çdo rast.

3. Me angazhimin në rregullimin e ujërave të Drinit dhe tharjes së Liqenit të Shkodrës, do të arrihej: së pari, angazhimi i kapitalit të huaj në Shqipëri, i cili ka prirje ndaj nesh. Në këtë mënyrë italianët nuk do të mbeteshin të vetmit të angazhuar në terrenin shqiptar. Dhe, së dyti, me një ndërmarrje të tillë të madhe të përbashkët, logjikisht do të krijoheshin rrethanat për një raport më të durueshëm dhe afrimi midis nesh.

4. Një zgjidhje më e mirë dhe më e drejtë e çështjes së pronarëve përtej kufirit, sidomos lehtësime në rastin e kalimit [kufirit – E.A.B.] për punimet në pronat [e tyre – E.A.B.], ku ka vend dhe për zëvendësimin e tokave, dhe heqjen e taksave për kullotat për gjedhe në pronat personale [jashtë Shqipërisë – E.A.B.], do të arrihej një gjendje shumë e prekshme kënaqësie e popullsisë në brezin kufitar. Kjo, doemos do të ndikonte në prirjen e një pjese të masave [popullore – E.A.B.] afër kufirit tonë, drejt krijimit të bindjes se Jugosllavia i mbështet ata.

5. Përmes shkëmbimit të mallrave, do të ngrihej niveli ekonomik i vendit dhe një numër i madh individësh përmes interesit do të lidheshin me ne. Me ngritjen ekonomike për një kohëzgjatje më të madhe, do të arrihej edhe ulja e nivelit të varësisë ndaj Italisë. Penetrimi ekonomik do të mund të arrihet vetëm me krijimin e ndonjë institucioni financiar, i cili do të mbështeste angazhimin tonë. Kjo mund të arrihet ose me formimin

* Me “aksionin” në Shqipëri nënkuptohej kryesisht veprimtaria e nëndheshme jugosllave.

e ndonjë banke jugosllave-shqiptare, ose me hapjen e filialeve në Shkodër, Durrës dhe Korçë, të bankave tona të banovinave* të Zetës dhe të Vardarit.

6. Me zgjidhjen e çështjes së pranimit të Kishës Autoqefale Ortodokse Shqiptare, do të hiqej nga rendi i ditës një çështje, e cila mund të zgjidhet edhe pa ne dhe kundër nesh. Duke marrë në dorë iniciativën nga ana jonë, ne mund të arrijmë që gradualisht të emërojmë disa fetër në fshatrat sllave rreth Liqenit të Prespës dhe atij të Ohrit, dhe që të ruhet gjendja aktuale në Shkodër dhe Vrakë. Në qoftë se, qeveria shqiptare kërkon nga ne që ta ndihmojmë sa i përket kësaj çështjeje, mendoj që nuk duhet ta refuzojmë ndihmën tonë. Përndryshe, nuk është e këshillueshme që të vazhdojë edhe më tej gjendja e palogjikshme, duke mos e pranuar kishën të cilën e krijuam vetë. Luftojmë kundër saj, ndërkohë që e paguajmë shefin e saj.

Përderisa të qëndrojmë në këmbë regjimi i Zogut, mund dhe duhet të angazhohemi në këtë drejtim. Sidomos në rrafshin ekonomik duhet të angazhohemi më shumë, në mënyrë që të mos u lihet në dorë e gjitha italianëve, dhe përveç kësaj, të krijojmë interesa të caktuar ekonomike, të cilët me të drejtë do t'i mbronim [jugosllavët – E.A.B.]. Me indiferencën ndaj Shqipërisë ne do të humbim miqtë tanë të mëhershëm dhe qëndrimin pro nesh të fiseve të cilat kanë qenë të prira ndaj nesh.

Ky është aksioni që duhet të zbatohet gjithsesi, kushdo që të jetë në krye të Shqipërisë. Por, për shkak të gjendjes shëndetësore të Mbretit Zog dhe duke pasur parasysh mundësinë që në Shqipëri shpejt e lehtë mund të përfundojë jeta e cilitdo, do të duhej që të ndërmerren disa masa të posaçme dhe speciale:

1. Ne nuk mund të lejojmë që ngjarjet të cilat mund të ndodhin, të na gjejnë të papërgatitur dhe të paorganizuar. Ka dy mundësi që të mbrojmë interesat tona në Shqipëri: a) me një marrëveshje të drejtpërdrejtë me italianët; b) angazhimi në forcimin e miqve tanë dhe krijimin-përgatitjen e pasardhësit të regjimit të Zogut. Mundësia e parë varet prej politikës së përgjithshme të vendit tonë dhe nga pozita e tij ndërkombëtare. Unë mendoj se aktualisht duhet të mendohet më shumë për opsionin e dytë. Sipas mendimit tim, do të duhej që me të gjitha mjetet ta ndihmojmë organizatën nacionaliste** në Shqipëri. Ata [anëtarët

* Me reformën administrative të vitit 1929, Jugosllavia u nda në “banovina”.

** Fjala është për Organizatën e Fshehtë antizogiste me qendër në Vlorë.

e organizatës – E.A.B.] të lidhen me emigracionin [shqiptar jashtë nën ndikimin jugosllav – E.A.B.] dhe në këtë mënyrë të krijohet një forcë reale, e cila do të trashëgonte regjimin aktual në Shqipëri. Lidhur me këtë duhet që t'u jepet një parapagesë për nevojat e organizatës. Me rastin e përfundimit të organizimit dhe të përcaktimit të kreut përgjegjës, t'u jepet ndihma e radhës me kushtin që mos të ndërmerret asnjë aksion pa dijen dhe miratimin tonë. Lartësia e parapagesës së parë, nuk do të duhej ta kalonte shumë prej 500 napolonave*. Të ardhurat për veprimtarinë e mëtejshme do të përcaktoheshin në harmoni me rezultatet konkrete.

2. Do të duhej që të rritej krediti** për ndihmë për krerët fisnorë, sidomos të atyre të prefekturës së Shkodrës dhe të Peshkopisë. Në rrethanat e sotme të vështira ekonomike, përveç kredive të deritanishme [shumës – E.A.B.], nuk do të duhej më shumë se 20 000 franga në muaj. Me këtë shumë mund të ndihmohen nga 50 deri në 100 individë të dalluar. Tani për tani, kjo është e mjaftueshme. Në rast nevoje, kreditë do të rriteshin.

3. Është e nevojshme që në Shqipëri të kemi së paku një gazetë, e cila do të mbronte këndvështrimin tonë dhe interesat tona. Deri më tani, janë derdhur kot sasi të ndjeshme [të ardhurash – E.A.B.] dhe nuk kemi arritur asgjë. Madje janë paguar gazetarë, të cilët na kanë sulmuar apo na sulmojnë. Kështu, gazetarit Çekrezi i janë dhënë 300 napolona, ndërsa ai na sulmon! Unë mendoj se do të duhej të ndihmohej gazetari Nebil Çika, të cilin edhe kështu e ndihmojmë, në mënyrë që të nxjerrë një revistë, e cila do të dilte në Tiranë, 2-3 herë në javë. Për këtë qëllim do të duhej, së paku për fillim, rreth 10 000*** [? – E.A.B.] në muaj. Në rast të angazhimit tonë intensiv ekonomik, ky subvencion mund të jetë në masë më të kufizuar, ngaqë revista mund të subvencionohej përmes shpalljeve nga ndërmarrjet tona.”

* Një napolon = 20 fr. ari.

** Fjala është për kredinë e përhershme të qeverisë jugosllave për veprimtari subversive në Shqipëri.

*** Nuk është shënuar a bëhet fjalë për frëng ari apo napolona. Ngaqë Gjonoviqi herë e herë evidencon frangun e herë napolonat, çështja mbetet e hapur. Meqë kjo është një shumë e madhe, besoj se bëhet fjalë për fr. ari.

